


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 4082 REP
NR. 1450 KOL



U pagua taksa e pulles

KONTRATE DHURIM KUOTASH

Ne Tirane, Shqiperi, sot me 02.12.2020 (dymije e njezete), ne pranine time **Edlira Malaj (Galaxhi)**, Notere e Dhomes se Notereve te Tiranës, me seli ne rruga Sami Frasheri Tirane, u paraqiten palet si me poshte:

DHURUESI

Shoqëria "NOI CASH AND CARY" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 08.06.2020, me NUIS M03008601K e perfaqesuar nga **Erjon Basha**, atesia Ismir, lindur me 22.12.1983, ne Gjirokaste dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga karta identitetit me nr.personal **I31222026H**, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e pergjithshem te shoqerise.

PRANUESE E DHURIMIT

Anila Çako, lindur me 29.03.1972, ne Gjirokaster, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga karta identitetit me nr.personal **H25329020D**.

(Dhuruesi Dhe Pranuesi dhurimit do ti referohemi ne kete kontrate se bashku palet dhe vec e vec pala.)

Une, Noteri, pas verifikimit te dokumentave te depozituara direkt nga palet ose nga perfaqesuesit e tyre, vertetoj se palet kane zotesi juridike per te vepruar. Bazuar ne vullnetin e tyre te lire, palet kerkuan dhe jane dakort qe te hartoj kete kontrate dhurim kuotash bazuar ne ligjet e Republikes se Shqiperise me keto terma dhe kushte si me poshte:

Kushtet paraprake

Shoqëria "NOI CASH AND CARY" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 08.06.2020, me NUIS M03008601K, me zyrën qendrore në Gjirokaster, Dropull i poshtem **Dervican, Rruga Nacionale**.

Dhuruesi **Erjon Basha**, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e pergjithshem te shoqerise, ku kapitali i shoqerise eshte ne vleren me kapital të regjistruar 100,00 (njëqind) lekë, me ortak te vetem Erjon Basha, zotërues te 1 (një) kuote me vlerë 100,00 (njëqind) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë;

Sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate, dhuruesi i dhuron **Anila Çako** Kuoten ne Dhurim, ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 1 Objekti

Nëpërmjet kësaj kontrate pala dhuruese **Erjon Basha**, i dhuron znj. **Anila Çako**, kuotën që ai zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "NOI CASH AND CARY" SHPK dhe që përbën 49% të kapitalit të kësaj shoqërie, e barabarte me nje kuote.

Dhuruesi pranon ti dhuroje znj. **Anila Çako** kuoten ne dhurim qe perben 49 % (dyzete e nente) te kapitalit themeltar te shoqerise e cila konsiston ne 1 (nje) kuote, znj. **Anila Çako** do te behet zoteruese e nje kuote qe perfaqeson 49% te pjesemarrjes ne kapitalin e pergjithshem te shoqerise, dhe z. **Erion Basha**, do te zoteroje 51 % te pjesemarrjes ne kapitalin e pergjithshem te shoqerise, e barabarte me 1(nje) kuote.

Z. Erion Basha, do te ngelet administrator i shoqerise dhe do te bej te mundur depozitimn e ketij akti prane QKB.

Me dhurimin nga dhuruesi te kuotave ne dhurim prej Erjon Basha, znj. Anila Çako, behet zoteruese e 1 (nje) kuote ne shoqerine e cila perben 49 % (dyzete e nente) te kapitalit themeltar te shoqerise Erjon Basha, behet zoterues i nje kuote qe perfaqeson 51% te shoqerise.

Dhuruesja fiton pronesine mbi Kuotat, dhe te gjitha te drejtat e lidhura me pronesine, mbi Kuotat ne dhurim, ne Daten e Nenshkrimimit. Dhuruesit i lind e drejta ne Daten e Nenshkrimimit te regjistroje pronesine e tij mbi Kuotat ne dhurim ne QKB, ne librat e Shoqerise dhe ne cdo organ tjeter kompetent.

1. Qellimi i Kontrates

Subjektet e termave dhe kushteve te kesaj kontrate, dhuruesi eshte dakort te dhuroje, transferoje dhe dorezoje tek pranuesi i dhurimit dhe pranuesi i dhurimit eshte dakort te pranoje dorezimin e kuotave te shoqerise NOI CASH AND CARY" SHPK. Dhurimi i kuotave behet pa asnje kundershperblim.

Pranuesi i dhurimit do te marre te gjitha veprimet per te regjistruar kontraten e dhurimit te kuotave sic kerkohet nga ligjet e Republikes se Shqiperise per depozitimim e kesaj kontrate ne QKB te rrethit perkates.

Perfaqesimet dhe Garancite

Pala dhuruese perfaqeson dhe garanton si me poshte:

Ekzekutimi i caktuar.

Kjo kontrate eshte ekzekutuar nga pala pranuese e dhurimit dhe kjo kontrate konstituon detyrime te vlefshme dhe ligjerisht te detyrueshme per pranuesin e dhurimit te zbatueshme ne perputhje me termat e saj.

Pa konflikt. Hartimi i kesaj kontrate dhe perputhshmeria me termat ketu, nuk do te jete ne konflikt me /ose rezultojte ne shkelje me ndonje dispozite apo te kerkoje ndonje pelqim ose te rezultojte ne imponim te ndonje pengu, te ndonje marreveshje ose instrumenti ne te cilin dhuruesi eshte pale ose dhuruesi ose ndonje nga asetet jane te detyruar; dhe nuk do te paguaje ose nje fakt i cili me dhenien e njoftimit, kalimi i kohës ose kryerja e ndonjë përcaktimi ose ndonje kombinimi ketu, do te perbeje mospermbushje te detyrimeve te kesaj kontrate.

Dhuruesi eshte pronari ligjor dhe i vetem i kuotave, te lira nga cdo pengese apo barre/ apo pergjegjesi. Kjo ne baze te vertetimit leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese. Dhuruesi ka te drejte te dhuroje apo te prokuroje transferimin e kuotave tek pala pranuese sipas termave te pershkruara ne kete kontrate.

2. Te Ndryshme

Cdo njoftim, aplikim, ose komunikim tjeter qe duhet dhene ose bere sipas kesaj kontrate kundrejt pranuesit te dhurimit dhe dhuresit do te behet me shkrim pervec kur parashikohet ndryshe ne kontrate. Njoftimi, kerkesa ose komunikim tjeter do te konsiderohet qe i eshte dhene ose bere kur ai do t'i dorezohet dorazi, me poste pales te ciles i kerkohet ose lejohet t'i jepet ose bere ne adresen e pales ose adrese tjeter qe pala ka caktuar, duke e njoftuar palen tjeter per te dhene apo bere njoftime te tilla, aplikime ose komunikime te tjera.

Ligji i Zbatueshem dhe Juridiksioni.

Kjo kontrate do te hartohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjin shqiptar. Cdo mosmarreveshje, polemike ose pretendim qe ka ardhur si rezultat i zbatimit te kesaj kontrate ose prishje, mbarim, ose pavlefshmeri prej kesaj, do te zgjidhet nga gjykata kompetente Shqiptare.

Gjuha. Kjo kontrate u hartua ne gjuhen shqipe ne 4 (kater) kopje me fuqi te njejte ligjore.

Une, Notere Publike, pasi u lexova Paleve me ze te larte permbajtjen e plote te kesaj kontrate, e gjej kontraten ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe pasi Palet nenshkruan ne pranine time, vertetoj firmat sipas ligjit shqiptar.

DHURUESI
ERJON BASHA

NOTERE
EDLIRA MALAJ GALANXHI

PRANUESI I DHURIMIT
ANILA ÇAKO



Handwritten signature of Anila Çako in blue ink.

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2020030516313231
Data e Rezultatit të Kërkimit: 02.12.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 4:03:13PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-574-923
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

Shoqëria "NOI CASH AND CARY" SH.P.K

